

çila ka një pamje të egër. Më të mëngjër shkëmbinjtë të lartër e të mprehtë e më të djathtë prapë shkëmbinjtë si thikë. Në mes shkon Fani, uja e të cilit ecën më rëmbim, edhe është tërë shkumbë të bardhë.

Jo shumë lark prej grykës na është katundi i parë i Fanit i cili quhet Bisak. Në këtë vënt vëndosmë të zemë shtek. Kaluam një urë të vogël e të rëzikëshme të lumit dhe pastaj rramë në fshat, ku xhandari na shpuri ne shtëpia e kryeplakut.

Edhe ky mik na pret jo më mirë dhe ndënjmë një natë në shtëpin' e tij. Kryeplaku ka patur një vajzë edhe një djalë, pa goca na tha se kish mbetur virgjineshë për hirin e babës së saj dhe vllaut të vetëm. Ish nonj'a 22 vjeç, mjaft e mirkë, dhe pandeva se mos të ndënjurit si virgjireshë i detyroheshe nonjë shkaku që kish të bënte me zemrën dhe jo sakrificës që bënte për njerëzit të saj. E pyeta mi këtë çështje dhe më tha se me të vërtetë nuk po marthohesh nga shkaku i vllaut të vetëm, me të cilin kish qef të pleqëroheshe.

Passi matmë disa burra të Fanit, e lamë shtëpin e Kryeplakut me shumë falenderime dhe ja muarm gjith po rrugës së më parëshme, tanidyeke patur Munellën më të djathtë dhe Malin e Shenjt më të mëngjër. Dreka na zuri ke katun-